



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:191843

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734040

P.nr.190/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.(A.) M. nga M., për shkak të veprës penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par. 5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.1725/2022 të datës 27.11.2023 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 27.03.2024, në prezencën e prokurores së shtetit Venera Shala, të akuzuarit A. M., së bashku me mbrojtësin e tij Faik Morina avokat në Malishevë, **më 02 prill 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. M.**, i lindur më ... nga Malisheva, Rr “I.K.” nr. ..., nga i ati A. dhe e ëma N., e gjinisë T., i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar më parë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më 07.05.2021 në Rr. “I. K.” në M., saktësisht në depon e objektit e cila është ne pronësi të të pandehurit, i cili në cilësinë e menaxherit dhe pronarit të lokalit “A. L.”, me qëllim që vetit ti mundësoj shmangien nga pagesa e tarifave të akcizës, posedon produkte

akcizore pa banderola, në atë mënyrë që gjatë kontrollit së realizuar më 07.05.2021 nga D. e Kosovës, është konstatuar se në lokalitetin e lartcekur, i pandehuri ka poseduar kg N./ shije e markës “...” prodhim i Gj., paketime 1 kilogramësh pa banderola të Kosovës, me ç’ rast buxhetit të Republikës së Kosovës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej euro.

- me çka ka kryer veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.5 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,43,44,69,70,312 par.5 të KPRK-së, si dhe nenit 241,242,364,365,449 par. 1 dhe par. 2 nën par. 2.6 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM

Ashtu që i pandehuri **A. M.**, dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **TETËMIJË (8000) EURO**, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **NJËQIND E PESËDHJETË (150) DITËSH**.

I pandehuri **A. M.**, dënimin me gjobë në shumë prej tetë mijë (8000) Euro, është i detyruar ta paguaj në afat prej katër (4) këste në afat prej katër (4) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë: kësti i parë në shumën prej dymijë (2000) Euro, do të paguhet deri me datën 05, të muajit të parë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; kësti i dytë në shumën prej dymijë (2000) Euro, do të paguhet deri me datën 05, të muajit të dytë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; kësti i tretë në shumën prej dymijë (2000) Euro, do të paguhet deri me datën 05, të muajit të tretë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; dhe kësti i katërt në shumën prej dymijë (2000) Euro, do të paguhet deri me datën 05, të muajit të katërt pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim

burgimi në kohëzgjatje prej katërqind (400) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Të pandehurit **A. M.**, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 44 par. 1 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **A. M.**, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) Euro.

Nëse i pandehuri **A. M.**, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë dënimi i zëvendësuar me gjobë do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditësh.

Në bazë të nenit 312 paragrafi 6 të KPRK-së, lidhur me nenin 269 dhe 276 të KPP-së, **KONFISKOHEN:** 1190 kg Nargjile/ shije e markës “...” prodhim i Gj., paketime 1 kilogramësh pa banderola të Kosovës, të cilat janë objekt i kryerjes së veprës penale. Malli gjendet në depot e D.së Republikës së Kosovës.

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 euro, si dhe për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 70,00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara D. e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 1725/2022, të datës 27.11.2023, kundër të akzuarit A.(A.) M. nga M., për shkak të veprës penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par. 5 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 27.03.2024. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e Shtetit Venera Shala. Të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokuroja e shtetit Venera Shala deklaron se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A. M., duke marr parasysh që i njëjti e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e gjithashtu konsideroj se ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare pasi që i njëjti u konsultua mjaftueshëm me të mbrojturin e tij dhe i kupton benefitet të cilat janë si rrjedhojë e këtij pranimi të fajësisë. Gjithashtu nuk e kundërshtoj këtë pranim fajësie sepse gjen mbështetje të plotë në faktet e çështjes të prezantuar nga prokuroria e shtetit, e gjithashtu aktakuza e prezantuar nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore. Andaj sa i përket rrethanave lehtësuese lus gjykatën që të ketë parasysh në shqiptimin e sanksionit penal dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, bashkëpunimin e tij me prokurorin dhe doganën, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese kërkoj nga gjykata që të ketë parasysh fillimisht shkallën e lartë të dashjes së tij për kryerjen e kësaj vepre penale, të ketë parasysh përgjegjësinë penale të të akuzuarit e gjithashtu edhe dëmin e ekonomisë që ju ka shkaktuar buxhetit në këtë rast Institucioneve të Republikës së Kosovës konkretisht D..

Mbrojtësi i të pandehurit A. M., Avokat Faik Morina deklaron se unë e mbështes të mbrojturin tim në pranimin e fajësisë para gjykatës, për veprën penale e cila i ngarkohet në aktakuzë dhe i propozojmë gjykatës që ta aprovojë këtë kërkesë. Nëse gjykata e aprovon në si mbrojtje kërkojmë nga gjykata që në rastin e caktimit të sanksionit penal ndaj të mbrojturit tim A. M., të merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë e në veçanti bashkëpunimin e A. M., me Doganën e Kosovës që nga data 07.05.2021 dhe më tutje ka vazhduar, në dhënien e të dhënave të Doganës për akterët e tjerë dhe personat nga të cilët e ka marrë këtë mall si në aktakuzë. Po ashtu lidhur me veprën penale A. M., me datën 24.11.2023, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë në intervestim nga kjo e fundit e ka pranuar fajësinë, ka deklaruar bashkëpunim me Doganën duke i treguar prokurorit ato që ka bashkëpunuar me Doganën dhe ka kërkuar benefit lidhur me këtë. Po ashtu gjykata të merr si rrethanë lehtësuese edhe paraqitjen e rregullt të A. para Prokurorisë dhe gjykatës, të merr rrethanat e tij personale, të merr gjendjen e tij ekonomike parasysh, kur e them këtë e potencoj se nga momenti i konfiskimit të këtij malli, me datën 07.05.2021 firma e A. M. ka falimentuar dhe është

mbyllur, kështu që tani A. M., është i papunësuar, jeton me ndihmën e vëllezërve në aspektin ekonomik dhe financiar, kështu që përfundimisht gjykatës i propozojmë se në rastin e caktimit të sanksionit penal, nëse dënohet me burgim brenda dispozitave ligjore të kthehet me dënim me gjobë dhe mundësisht të dënohet me ndonjë dënim alternativ, dënim me kusht dhe me gjobë.

I akuzuari A. M. deklaroj se: unë e pranoj fajin pasi që për këtë u konsultova me avokatin tim, por unë kërkoj një masë lehtësuese pasi që unë mallin e kam blerë në Kosovë, unë nuk e kam sjell nga jashtë që ta dëmtojë Doganën e Kosovës. Unë nga dita e parë kam qenë bashkëpunëtor dhe bashkëpunues me Doganën e Kosovës ku njëkohësisht, me emër e mbiemër ju kam treguar personin nga i cili jam furnizuar, ku Doganës së Kosovës ja kam dhënë emër e mbiemër, numër telefonit bile edhe targat e veturës, për ata kërkojë nga gjykata që të më bëhet një lehtësim për një dënim sa më të vogël për veprën apo gabimin që unë jam furnizuar me atë mall të pa doganuar.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Autorizim për hetim dhe mbledhjen e të dhënave nga Dogana e Kosovës e datës 30.03.2023; raport i Inteligjencës i kufizuar/konfidencial 5x5x5 i datës 03.02.2021; procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit A. M., më datë 07.05.2021; listë distribumi e Doganës së Kosovës e datës 11.05.2021; foto dokumentacion; urdhëresë për sekuestrimin e përkohshëm i datës 12.05.2021; raport për ekspertimit për Prokurorinë Themelore në Gjakovë i datës 31.01.2022; formulari i pranimit-dorëzimit të provave për ekspertim; urdhëresë për ekzaminimin e provës materiale e datës 11.05.2021; listë distribuomi e datës 28.05.2021; raport i Inteligjencës i kufizuar/konfidencial 5x5x5 i datës 26.08.2022; komunikimi me mesazhe në rrjete sociale gjithsej ... faqe; out raport i Inteligjencës Nr.....; komunikimi me mesazhe në rrjete sociale gjithsej 47 faqe; kopje e dërgesës parash nga A. T.për D. A. W.; Dogana e Kosovës PKK "D. i b." Nr. i prot.....12.2019; raport i Inteligjencës i kufizuar/konfidencial 5x5x5 i datës 15.07.2022 si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e

ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë dhe atë: **I.** P.nr.119/2005, nga neni 332 i dënuar me gjobë në shumën prej njëqind (100) euro, i plotfuqishëm më 16.01.2006; **II.** P.nr.227/2012, nga neni 153 i dënuar me kusht prej tre (3) muajve brenda një (1) viti, i plotfuqishëm më 25.05.2015; **III.** P.nr.173/2003, nga neni 205 i dënuar me kusht prej tre (3) muajve brenda një (1) viti, dhe masë sigurie marrja e deklaratës doganore nr...., dhe lejen e qarkullimit VRD ..., i plotfuqishëm më 03.03.2004; **IV.** P.nr.130/2020, nga neni 406 i dënuar me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, i plotfuqishëm më 30.11.2020; **V.** P.nr.229/2018, nga neni 314, i dënuar me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, i plotfuqishëm më 14.04.2021; **VI.** P.nr.150/2020, nga neni 406 i dënuar me gjobë në shumën prej shtatëqind (700) euro, i plotfuqishëm më 26.01.2022; **VII.** P.nr.129/2021, nga neni 181, i dënuar me gjobë në shumën prej nëntëqind (900) euro, i plotfuqishëm më 02.08.2022; **VIII.** P.nr.159/2022, nga neni 314 i dënuar me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, i plotfuqishëm më 12.02.2024. Të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim **UNIK ME GJOBË** në shumën prej **DHJETËMIJË (10.000) euro**, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

I pandehuri **A. M., NUK** është detyruar që t'ia kompenson Doganës së Kosovës - Buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej 51,469.76 euro, me arsyetimin se: Dogana e Kosovës nëpërmjet zyrtarit ligjor M. K., i cili më 28.03.2024, i ka dërguar Gjykatës një E - mail ku ka deklaruar se **"Bazuar ne shkresat e lëndës P.nr.190/2023, malli është propozuar qe te konfiskohet dhe gjithashtu malli gjendet ne depot e**

doganës. Nëse malli i nënshtrohet konfiskimit atëherë pala nuk ka obligim të paguaj taksa doganore, nëse jo atëherë janë të kalkuluar taksat në shkresën e sektorit të vlerës nr."

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**

P. nr. 190/2023, më 02 prill 2024

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.